



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:115126

Datë: 27.06.2019

Numri i dokumentit: 00381791

PKR.nr.89/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Rrezarta Sylaj, në çështjen penale kundër të pandehurve A. Z. nga Gjilani, të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av.Enver Halili dhe B. D. nga Gjilani, të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av.Elvira Haziri, që të dy për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.I.nr.92/2019, të datës 10.06.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 27.06.2019, mori dhe shpalli publikisht në të njëjtën ditë, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A. Z., nga babai dhe nëna, e lindur ,i lindur me datë 30.05.1981, në Gjilan, me vendbanim në lagjen “.....” nr.17, i martuar, ka të kryer fakultetin e Edukatës Fizike, profesor në gjimnazin “Zenel Hajdini” në Gjilan, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. të tel.cel. 044-..... me nr të letërnjoftimit,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I pandehuri B. D., nga babai dhe nëna, e lindur ,i lindur me datë 27.04.1975, në fsh. Koretin, Komuna e Kamenicës, me vendbanimi në Gjilan rr. “.....” lagjia 8nr63, i martuar, prind, ka të kryer Shkollen Fillore, punon sigurim në në Gjilan, i gjendjes sëvarfër ekonomike, me nr. të tel.cel. 044-..... me nr të letërnjoftimit,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I. I pandehuri A. Z.

Sepse më datë 13.04.2019 i pandehuri paautorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët ka mbajtur në pronësi armë të zjarrit ashtu që në shtëpinë e tij në Gjilan në rrugën “.....” nr.17 saktësisht në dhomën e tij të fjetjes në ditën e martësës është fotografuar me armë në dorë , ashtu që në rrjetin e ti social Facebook i ka postuar 2 foto duke e mbajtur armën e markës TT në dorë .

- Me këtë ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK-ës.

II. I Pandehuri Bujar Demi

Në kohë të papërcaktuar, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armë të zjarrtë, ashtu që më datë 13,04,2019 në rr. “” nr.17, në shtëpinë e nipit të tij- tani të pandehurit A. Z., i pandehuri armën e markës TT ia jep të pandehurit A. Z. me qëllim që të fotografohet me të.

- Me këtë ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj, në bazë të nenit 4,41,42,43,46,69, 73,74 , 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe nenit 233 dhe 365 dhe 450 të KPPRK-ës:

I GJYKON

Të Pandehurin A. Z. me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , të cilin gjobë I pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Të Pandehurin B. D. me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , të cilin gjobë I pandehuri do ta paguaj në afat prej 15

ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajnë shumën prej nga 20 euro secili prej tyre dhe secili prej tyre shumat prej nga 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

Konfiskohen: Arma e markës TT, e pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjta do të asgjësohet.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Renda, me dt. **29.03.2019**, ka ngritur aktakuzën **PP/I nr. 92/2019**, ndaj të akuzuarve **A. Z. dhe B. D.**, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga **neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se**, duke kërkuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të pandehurit të shpallen fajtor dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datën **27.06.2019**, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kësaj gjykate i është dorëzuar një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të pandehurve A. Z. nga Gjilani, me avokatin mbrojtës sipas detyrës zyrtare av. Enver Halili dhe B. D. nga Gjilani ,me avokatin mbrojtës sipas detyrës zyrtare av. Elvira Haziri

Gjykata ka aprovuar këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, nga të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre.

Gjykata ka aprovuar këtë marrëveshje për pranimin të fajësisë, për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pa asnjë presion, duke i ditur pasojat e pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarve

Gjatë matjes dhe shqyrtimit të dënimit, gjykata ka pasur parasysh sjelljen

e mire të të pandehurve në gjykatë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve pa asnjë hezitim , pendimin për veprën e kryer dhe kërkim faljen.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Gjykata ka konfiskuar armën TT.

Të pandehurit janë obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajnë shumat prej nga 20 euro secili prej tyre dhe shumat prej nga 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, për secilin prej tyre të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti për Krime të Rënda

Me datë 27.06.2019

Procesmbajtësja:

Rrezarta Sylaj

Kryetari i trupit gjykues:

Naser Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2019:115126
Datë: 27.06.2019
Numri i dokumentit: 00381791